



**PLANI I
DETAJUAR I
TRAJNIMEVE DHE
STËRVITJEVE PËR
VITIN 2025**

QNOD

MIRATOHET
DREJTORI ADMINISTRATIV I QNOD
ZYBER DUSHKU

Përgatiti: Sektori i Analizës ,Planifikimit dhe Trajnimeve
Elton Aliaj

DAKORTËSUAR

Koordinatorët Institucionalë në QNOD:

RB:	Kap. Rang. II	Besnik Thana
PKM:	Kryekomisar	Kastriot Lemnusha
A/ Kontrabanda:	Civil	Besnik Limaj
MBZHR:	Civil	Arjan Veizi
Administrata Detare:	Civil	Sokol Merdhoci
M. T. Mjedisit:	Civil	Dorian Sheshi

PËRMBAJTJA

Hyrje

Misioni

Qëllimi i Planit të Trajnimeve dhe Stërvitjeve

Objektivat

Drejtimet kryesore

I. Trajnimet dhe stërvitjet ndërinstitucionale

II. Trajnimet që ofrohen nga Ministria e Mbrojtjes

III. Trajnimet dhe vizitat që ofrohen nga partnerët, misionet, projektet ndërkombëtare, etj

Matrica e aktiviteteve kryesore të QNOD-së për vitin 2025

Nr	Tema Trajnimit	Struktura Organizative	Struktura Bashkepunuese	Periudha e trajnimit	Ditë trajnimi	Nr i pjesmarreve	Vendi	Kosto e Trajnimit
1	Plani i Masave për reagimin ndaj ndotjes në shkallën I,II,III.	QNOD	Prefekturat dhe bashkitë që kanë dalje në det, portet shtetërore dhe portet private	1 prill- 30 Prill	3	70	Durrës Shkodër Vlorë	9300
2	Përdorimi i sistemit “Baza e të Dhënave për Trafikun Detar”	QNOD	Institucionet pjesë e QNOD-së dhe institucionet me interes në det sipas kërkesave të tyre.	Papërcakuar	12	300	Durrës Shëngjin Vlorë Sarandë	124100
3	Trajno trajnuesin	QNOD	UNODC	Papërcaktuar	5	5	Papërcaktuar	
4	Maritime Cybersecurity	QNOD		Papërcaktuar	5	5	Papërcaktuar	
5	Njohja e legjislacionit shqiptar të detit dhe institucioneve me interesa në të	QNOD	Institucionet pjesë e QNOD-së	1 Shtator- 30 Shtator	5	20	Durrës Vlorë Sarandë	2300
6	Ndjekja e procedurave për vlerësimin e informacionit dhe marrjen e vendimeve sipas regjimeve të caktuara operaconale	QNOD	Institucionet pjesë e QNOD-së	1 Tetor- 30 Tetor	5	25	Durrë	2600

7	Trajnim mbi përdorimin e aplikacionit Lloyd's informa	QNOD	Institucionet pjesë e QNOD-së	Papercaktuar	1	20	Durrës	0
8	Reagimi ndaj ndotjeve detare	UNODC,E MSA	Institucionet pjesë e QNOD-së	Papercaktuar	5		Papercaktuar	
9	Shkëmbimi më i mirë i informacionit, me institucionet bashkëpunuese të vendeve	QNOD	Institucionet pjesë e QNOD-së	Papercaktuar	2	20	Mal i zi	Me mbështetje strukturale ndërko mbëtare të bashkëpunimit
10	Plani Kombëtar i Integritetit Evropian, Procesi Screening	MB	QNOD	Papercaktuar	1		Papercaktuar	
11	Reagimi ndaj ndotjeve detare (Oil spill Response)	QNOD	Prefekturat dhe bashkitë që kanë dalje në det, portet shtetërore dhe portet private	Papercaktuar	5	Papercaktuar	Papercaktuar	Me mbështetje UNDP
12	SAR/ Reagimi ndaj ndotjeve detare	QNOD/Qendra e simulimit MM	Qendra e simulimit, QNOD, PKM, RB, Dogana, Kapiteneria, Peshkimi, QKSH, Fajrore, Mjedisi	Papercaktuar	10			200
13	Masat e sigurisë për bivat, hartat hidrografike	QNOD, Hidrografia, IALA	Institucionet pjesë e QNOD-se	Papercaktuar	20			Me mbështetje IALA
14	Vizita studimore	Vizita studimore në qendrat homologe me qëllim rritjen e bashkëpunimit rajonal, shkëmbimi i informacionit, etj.	UNODC, EU4LEA, IPA, Frontex, UNDP, ICITAP, UK BF - Forca Kufitare Britanike), etj.	Papercaktuar	10			UNODC, EU4LEA, IPA, Frontex, UNDP, ICITAP, UK BF - Forca Kufitare Britanike), etj

Hyrje

QNOD është një strukturë ndërinstitucionale, me gamë të gjerë veprimi, e krijuar për koordinimin e punës së disa institucioneve, që kanë interesa dhe përgjegjësi në zbatimin e ligjit në det, referuar nenit 32 të ligjit Nr.9251, datë 8.7.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”. QNOD bën të mundur bashkëpunimin e bashkëveprimin e të gjitha institucioneve pjesëmarrëse në të, me qëllim realizimin e objektivave strategjike për Qeverinë Shqiptare, sikurse janë: lufta kundër terrorizmit, kundër trafikëve të paligjshme, kundër armëve të dëmtimit në masë, kundër ndotjes së ambjentit, operacionet e kërkim – shpëtimit, turizmi, etj.

Trajnimi është i dizenuar për të përmirësuar performancën e punës dhe aftësitë njohëse për personelin e QNOD- së, por dhe të komandantëve të mjeteve detare. Proçesi i trajnimit, për vetë rëndësinë që ka, përcaktohet edhe në VKM Nr. 954 datë 30.9.2009 “Për organizimin, strukturën, funksionimin e Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD) dhe bashkëveprimin me institucionet shtetërore, që kanë interesa në det”, i ndryshuar.

Me anë të trajnimeve do të bëhet e mundur rritja e njohurive në ato fusha ku janë vërejtur mangësi nga viti i kaluar ose ka nevojë për forcim të njohurive ekzistuese. Në vazhdimësi të domosdoshmërisë për trajnim dhe mbarëvajtjes së punës në fushën e trajnimeve, në bashkëpunim me koordinatorët e institucioneve është përgatitur ky 1plan i trajnimeve dhe stërvitjeve, i cili ka si qëllim ndikimin në realizimin me sukses të misionit të QNOD-së, për kontrollin e hapësirës detare shqiptare dhe zbatimit të ligjshmërisë në det.

Misioni

Rritja e njohurive profesionale, kualifikimi dhe arritja e standardeve të kërkuara nga i gjithë personeli në QNOD (stafi mbështetës dhe ai operacional).

Qëllimi

1. Unifikimi i koncepteve dhe praktikave, gjuhës së komunikimit, mënyrës së planëzimit, organizimit dhe realizimit të operacioneve detare, për përshtatjen e standardeve ligjore dhe teknike.
2. Forcimi i bashkëpunimit dhe punës në grup, në drejtimin e operacioneve detare.
3. Shkëmbimi i informacionit në interes të zgjidhjes së situatave detare.

Objektivat

1. Aftësimi profesional i personelit, kryesisht në njohjen e legjislacionit detar (kombëtar dhe ndërkombëtar).
2. Rritja e bashkëveprimit ndërmjet grupeve të shërbimit, në aktivitetin e përditshëm, në fushën e operacioneve detare dhe mënyrat e zhvillimit të tyre.
3. Forcimi i bashkëpunimit për shkëmbimin e informacionit, komunikimit dhe teknologjisë në përdorim.
4. Njohja praktike e bregdetit në interes të zhvillimit të operacioneve detare në kohë dhe me kosto sa më të ulët.

Drejtimit kryesore

Drejtimit kryesore ku do të synohet, janë:

1) **Terreni** (skena, hapësira detare dhe vija bregdetare). Për realizimin me sukses të detyrës dhe përmbushjes së misionit të QNOD-së, një rëndësi të veçantë ka njohja e terrenit. Personeli duhet të njohë mirë terrenin, veçoritë e tij, vendet e përshtatshme që krijojnë kushte për shkeljen e ligjit, si dhe vendet me rrezik (vendet e mundshme ose me probabilitet më të madh) për zhvillimin e veprimtarive të paligjshme në det, zonat e vdekura të cilat nuk kanë mbulim nga radarët, etj. Gjithashtu, personeli duhet të njohë karakteristikat e çdo porti apo zone që mund të shfrytëzohen në favor të QNOD-së në rast ndërhyrjesh në det, për realizimin me sukses të operacionit apo të shpëtimit të jetës së njerëzve.

2) **Legjislacioni**. Një aspekt shumë i rëndësishëm gjatë aktivitetit të QNOD-së në përgjithësi dhe sidomos gjatë zhvillimit të operacioneve detare është njohja e legjislacionit, kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe marrëveshjet ndërkombëtare dypalëshe apo shumëpalëshe, ku shteti shqiptar është pjesë. Çdo aktivitet i QNOD-së bazohet mbi ligjin dhe zhvillohet në zbatim të tij. Çdo veprim që bën QNOD-ja, nëse nuk bëhet duke respektuar legjislacionin, mund të shkaktojë cënimin e të drejtave të qytetarëve apo të interesave të tyre ekonomike, gjë e cila sjell si pasojë që shtetit tonë t'i shkaktohet një dëm mjaft i madh ekonomik, si dhe humbja e besueshmërisë dhe seriozitetit të shtetit shqiptar në përgjithësi, dhe të QNOD-së në veçanti.

3) **Komunikimi**. Ky është një element i rëndësishëm i zhvillimit të operacioneve detare. Personeli duhet të standardizojë fjalorin (gjuhën e komunikimit shqip dhe anglisht sipas standardeve ndërkombëtare), të dijë mënyrat dhe mjetet e komunikimit, frekuencat e komunikimit, personat me të cilët do të komunikojë (zinxhiri i komandimit) dhe kodet e komunikimit. Të njohë mirë pajisjet që kanë në dispozicion dhe ato që do të instalohen, si dhe të zotërojnë në mënyrë perfekte përdorimin e tyre. Të njohë mirë burimet e informacionit dhe mënyrat për të përcaktuar besueshmërinë e informacionit të marrë.

4) **Operacionet detare**. Si pjesa kryesore dhe më me rëndësi për kryerjen e misionit dhe zbatimit të ligjit në det, do të synohet njohja sa më e mirë nga personeli, të llojeve të operacioneve në det, regjimet juridike dhe përgjegjësitë institucionale, si bëhet planizimi i një operacioni detar, elementët përbërës të planit, mënyra e koordinimit ndërmjet institucioneve për konkretizimin e një operacioni, mënyra e drejtimit dhe realizimi i tij, si dhe do të njihen edhe me vështirësitë apo të papriturat që mund të ndodhin gjatë një operacioni.

5) **Teknologjia**. Një element tjetër, i domosdoshëm dhe i rëndësishëm është teknologjia. Pajisjet që janë në dispozicion të QNOD-së duhet të zotërohen në mënyrë të plotë nga personeli që i përdor ato. Ata duhet të njohin radarët, sistemet, programet kompjuterike, mjetet lundruese, GPS dhe çdo lloj teknologjie të re që do të vihet në dispozicion e që i ndihmon në realizimin e detyrës dhe në punën e përditshme.

Nivelet e trajnimit

Në trajnim do të përfshihet personeli i QNOD-së, si dhe personeli i institucioneve bashkëvepruese me QNOD-në, si: PKM, RB, Dogana, Peshkimi, Mjedisi, Kapiteneria (personeli i sallës operacionale dhe personeli në terren), të cilët operojnë në hapësirën detare shqiptare.

Trajnimet do të ndahen, si më poshtë:

Trajnime Bazë: Çdo person i emëruar në QNOD dhe personeli i cili varet drejtpërdrejtë nga institucionet e përfshira në QNOD, por që merr pjesë në planifikimin, organizimin dhe realizimin e operacioneve në det duhet të marrë njohuritë bazë të nevojshme. Në këtë kurs trajnimi duhet të merren njohuritë bazë, si: legjislacioni kombëtar e ndërkombëtar mbi të drejtën e detit, institucionet kryesore të Komunitetit European dhe të NATO-s, institucionet rajonale të vëzhgimit dhe kontrollit të hapësirës detare, familjarizimi me strukturën dhe organizimin në QNOD, mënyrën e ndërveprimit midis institucioneve, llojet e operacioneve që janë kompetencë e QNOD-së, mënyrat e komunikimit, puna në sistem dhe hartë, leximi i sinjaleve të sistemit, përcaktimi i vendndodhjes në hartë, matja e distancave, etj.

Trajnime të avancuara: Trajnimi i avancuar i personave të cilët janë të përfshirë drejtpërdrejtë në realizimin e operacioneve detare. Këta punonjës duhet të trajnohen në mënyrë të zgjeruar për llojet e operacioneve detare, mënyrën e organizimit të tyre, mënyrën e bashkëveprimit ndërmjet institucioneve, etj. Këta persona duhet të kenë njohuri të thelluara për të gjitha operacionet që zhvillohen në det, ku konsistojnë këto operacione, veprimet dhe zonat e ndaluara në hapësirën detare për lundrim e peshkim, mjetet e ndaluara për tu përdorur në anije, format e ndaluara të peshkimit, operacionet e luftës kundër trafikeve të paligjshme, kontrabandës, mënyrat e bordimit, njohje të thelluara mbi teknologjinë dhe mjetet e përdorura në operacione, anijet dhe mënyra e lundrimit me to, veprat penale të cilat janë kompetencë e QNOD-së, elementët e tyre, mënyrat e shfaqjes së tyre, provat, mënyra e mbledhjes dhe administrimit të provave, shkeljet administrative, etj. Mënyrën e organizimit të operacioneve të ndryshme me pjesëmarrjen e një ose më shumë institucioneve.

Organizimi i trajnimeve dhe stërvitjeve

Trajnimet dhe stërvitjet do të jenë të vazhdueshme, afatshkurtra dhe afatgjata, me qëllim rritjen profesionale të stafit, njohjen dhe përshtatjen e tyre me ndryshimet ligjore, strukturore dhe teknologjike të vazhdueshme, si dhe bashkëpunimin ndërinstitucional në operacionet e ndryshme detare.

Trajnimet dhe stërvitjet do të zhvillohen në mënyrë teorike dhe praktike.

Trajnimet teorike do të organizohen në ambjentet e QNOD-së apo në ambjentet e institucioneve të tjera të përfshira në QNOD, në varësi të llojit dhe të numrit të pjesëmarrësve në trajnim, ndërsa ato praktike në hapësirën detare shqiptare, si: në Qendrën e Simulimeve, etj.

Për të bërë të mundur trajnimet në hapësirën detare, gjë e cila do të kërkojë mjete lundruese, do të bashkëpunohet me koordinatoret e institucioneve përkatëse për t'i vënë ato në dispozicion.

Në interes të trajnimeve dhe stërvitjeve në det do të shfrytëzohen dhe stërvitjet e planifikuara nga institucionet. Në këto stërvitje QNOD-ja do të marrë pjesë me personel kryesisht në të gjitha fazat e përgatitjes së stërvitjeve dhe si vëzhgues gjatë zhvillimit të stërvitjes.

Metodat e mësimdhënies teorike do të bazohen tek persona të kualifikuar për temën përkatëse të trajnimit, të cilët do të prezantojnë përmbajtjen teorike, pyetje – përgjigje, ushtrime praktike dhe testim për njohuritë e marra.

Me miratimin e Planit Vjetor të Trajnimit, Sektori Analizës, Planifikimit dhe Trajnimit në QNOD, në bazë të propozimeve të koordinatoreve, i paraqet Drejtorit Administrativ, listën e lektorëve që do të zhvillojnë trajnimin konkret, duke u bazuar në CV-të e tyre. Lektorët e përzgjedhur do të paraqesin paraprakisht leksionet në format elektronik. Këto leksione do të printohen në aq kopje sa është numri i personave që do të trajnohen.

Në vazhdimësi, nëse dalin kërkesa për trajnime ose stërvitje jashtë programit të miratuar, specialistë të QNOD-së dhe specialistë nga institucionet pjesëmarrëse në QNOD, do të mundësojnë realizimin e tyre, në interes të personelit.

Realizimi i Planit të Trajnimeve dhe Stërvitjeve

Realizimi i planit do të bëhet në bashkëpunim të ngushtë me koordinatorët institucionalë. Nga përgjegjësit e sektorëve dhe koordinatorët e institucioneve përcaktohen pjesëmarrësit për çdo trajnim, garantimin e prezencës së tyre dhe mbështetjen e plotë për realizimin e objektivave të caktuara. Në bazë të nivelit të njohurive dhe atyre që duhet të arrihen nga personeli, në bashkëpunim me koordinatorët institucionalë dhe me sektorët e trajnimit në institucionet përkatëse përgatitet dhe materiali (përmbajtja) e temave nga lektorët.

Me synim, realizimin e trajnimeve cilësore, QNOD bashkëpunon me institucionet kombëtare dhe të huaja, duke shfrytëzuar kryesisht institucionet e huaja që operojnë në Republikën e Shqipërisë dhe që ofrojnë asistencë në fushën e trajnimeve.

Ky plan i vihet në dispozicion të gjitha institucioneve përkatëse, me qëllim zbatimin e tij.

I. TRAJNIMET DHE STËRVITJET NDËRINSTITUCIONALE

Gjatë vitit 2025 janë planifikuar të zhvillohen 13 (trembedhjetë) trajnime ndërinstitutionale.

Temat e trajnimeve ndërinstitutionale:

Tema I: Plani masave dhe organizimi i grupeve të punës në terren, për reagimin ndaj ndotjes në shkallën e I, II dhe III. Vlerësimi i derdhjes, si dhe Impakti i ndotjes në shëndetin publik.

Pjesëmarrja me përfaqësues nga Institucionet:

Koordinatorët institucionalë (Mjedisi dhe Kapiteneria) dhe Grupi emergjencave detare (Prefekturat bregdetare dhe strukturat pjesë të emergjencave detare).

Qëllimi i Trajnimit:

Ky trajnim ka si qëllim njohjen e pjesëmarrësve me kërkesat e Planit Kombëtar të Reagimit ndaj Ndotjeve Detare nga Hidrokarburet. Të njihen pjesëmarrësit me Sistemin e komandimit të emergjencës (Grupet e Drejtimit dhe Reagimit) dhe detyrat e tyre. Të njihen pjesëmarrësit me disa forma të reagimit ndaj ndotjeve në det dhe në bregdet nga hidrokarburet. Të bëhet vlerësimi i ndotjes, duke marrë raste konkrete, si dhe ndikimi i ndotjes në shëndetin publik.

Subjekti shkurtuar i trajnimit:

Zbatimi i VKM Nr.480/2012

Metodologjia:

Trajnimi do të zhvillohet mbi një parapërgatitje të materialit të kursit (manual për pjesëmarrësit, prezantim në ppt), si dhe në shpjegime praktike. Mësimdhënia do të bëhet nga instruktorë të kualifikuar të Mjedisit, ARM-së dhe QNOD-së, të cilët do të prezantojnë përmbajtjen teorike dhe praktike, si dhe do t'i përgjigjen pyetjeve që bëjnë pjesëmarrësit.

Metoda vlerësimit: Shpjegime, diskutime, pyetje-përgjigje

Planifikimi (Periudha): Prill 2025

Kohëzgjatja: 3 ditë x 8 orë = 24 orë

Lektori: (QNOD)

Vendi: Shkodër ose Lezhë, Durrës ose Tiranë, Fier ose Vlorë

Nr I pjesëmarrësve: 70.

PËRMBAJTJA E PROGRAMIT MËSIMOR

Tema	Përmbajtja (Referenca)	Orë
Tema 1	Sistemi i Reagimit ndaj Ndotjeve Detare nga Hidrokarburet (SRNDH) Ndërtimi i Sistemit të Reagimit ndaj Ndotjeve Detare nga Hidrokarburet dhe kërkesat e tij.	2
Tema 2	Sistemi i komandimit të emergjencës Grupet e Drejtimit, Skuadrat e Reagimit dhe detyrat e tyre.	1
Tema 3	Mënyrat e reagimit ndaj ndotjeve Mënyrat e reagimit sipas llojit të bregdetit.	1
Tema 4	Vlerësimi i derdhjes, si dhe Impakti i ndotjes në shëndetin publik.	2
	Diskutime, Pyetje, Përgjigje	2
SHUMA: 3 ditë (Vlorë, Durrës dhe Shkodër) x 8 orë = 24 orë		7

Emërtimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma (Lekë)
Dieta/Shërbime (QNOD)	Rrugë	4	1000	4000
Dosje kartoni (të thjeshta)	Copë	70	60	4200
Blloqe të thjeshta për shënime	Copë	5	100	500
Letër A4	Risma	1	600	600
Shuma Totale				9300 lekë

Tema II: Përdorimi i sistemit “Baza e të Dhënave Shtetërore për Trafikun Detar”.

Grupet e synuara:

- a) agjencitë, agjentët detarë dhe përfaqësuesit e autorizuar të mjeteve lundruese;
- b) kapitenët dhe drejtuesit e mjeteve lundruese;
- c) përdorues sistemi, përfaqësues të institucioneve ligjzbatuese detare, si nga:
 - i. Drejtoria e Përgjithshme Detare;
 - ii. Policia Kufitare dhe Migracionit;
 - iii. Dogana dhe Antikontrabanda Detare;
 - iv. Roja Bregdetare;
 - v. Drejtoria e Shërbimit të Peshkimit dhe Akuakulturës;
 - vi. Autoriteti Portual dhe portet detare shqiptare shtetërore dhe private;
 - vii. strukturat vendore të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor (OSHKSH);
 - viii. struktura përgjegjëse për administrimin e informacionit dhe statistikave në mjedis;
 - ix. struktura përgjegjëse për përpunimin e informacionit dhe statistikave në turizëm;
 - x. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
- d) Dispeceria e Peshkimit
- e) Koordinatorët institucionalë dhe Grupet e shërbimit (në sallën operacionale dhe në terren)

Qëllimi i Trajnimit:

Ky trajnim ka si qëllim njohjen e sistemit “Baza e të Dhënave për Trafikun Detar” dhe ndryshimet e bëra rishtazi në SBDHSHTD. Ky trajnim do të zhvillohet sipas kërkesave të institucioneve ligjzbatuese.

Objektivat e Trajnimit:

1. Të familjarizojë të gjithë përdoruesit me sistemin BDHTD;
2. Praktikë mbi përdorimin e sistemit, duke përdorur tablet, kompjuter, laptop, etj.

Metodologjia:

Trajnimi do të zhvillohet mbi një parapërgatitje të materialit të kursit (manual për pjesëmarrësit, prezantim në ppt), si dhe në shpjegime praktike. Mësimdhënia do të bëhet nga instruktorë të kualifikuar të QNOD-së, të cilët do të prezantojnë përmbajtjen teorike dhe praktike, si dhe do t'i përgjigjen pyetjeve që bëjnë pjesëmarrësit.

Metoda vlerësimit: Shpjegime, diskutime, pyetje-përgjigje

Planifikimi (Periudha): 2025

Kohëzgjatja: 12 ditë x 8 orë = 96 orë

Lektori: (QNOD)

Vendi: Shëngjin, Durrës, Vlorë, Sarandë

Nr i pjesëmarrësve: Përcaktuar nga strukturat ligjzbatuese.

PËRMBAJTJA E PROGRAMIT MËSIMOR

Temat referuese për agjentët, përfaqësuesit e autorizuar të mjeteve lundruese, kapitenët dhe drejtuesit e mjeteve lundruese, përfaqësues të institucioneve ligjzbatuese detare (shtetërore dhe private), në terren

Tema	Përmbajtja (Referenca)	Orë
Tema 1	- Njohja me Modulin e administrimit të përdoruesve, roleve - Moduli i regjistrimit online të entiteteve - Njohja me Modulin e regjistrimit të mjeteve lundruese, organizatave dhe porteve	1
Tema 2	Njohja me Modulin e Hyrje-Daljeve në port (autorizimet përkatëse)	1
Tema 3	- Njohja me Modulin e njoftimeve automatike nga sistemi dhe nënshkrimit elektronik - Konfirmimet përkatëse	1
Tema 4	Njohja me Modulin GIS për ekspozim të dhënash në hartë	0.5
Tema 5	Njohja me Modulin e Riskut (Profili Riskut të Anijes)	0.5
Tema 6	Njohja me Modulin e Inspektimeve	1
Tema 7	- Njohja me Modulin e Raporteve dhe të dhënave statistikore - Njohja me Modulin e integritetit dhe/ose importimit të të dhënave me sistemet ekzistuese QNOD	0.5
Tema 8	Praktikë mbi përdorimin e sistemit	2
Pyetje Përgjigje	-	0.5
SHUMA	12 ditë (3 ditë në Shëngjin, 3 ditë në Durrës, 3 ditë në Vlorë, 3 ditë në Sarandë) x 8 orë = 96 orë	8

KOSTO FINANCARE

Emërtimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma (Lekë)
Dieta (QNOD)	Ditë	18	5500	99000
Dieta (QNOD)	Rrugë	18	1000	18000
Dosje	Copë	100	60	6000
Bloqe të thjeshta për shënime	Copë	5	100	500
Letër A4	Risma	1	600	600
Shuma Totale				124100

Tema III: Njohja e legjislacionit shqiptar për kontrollin dhe menaxhimin e hapësirës detare, si dhe njohja e zbatimi i marrëveshjeve midis institucioneve dhe marrëveshjeve dypalëshe me vendet fqinje. Njohja dhe zëbrthimi i detyrimeve të QNOD-së, në zbatim të Konventës së Kombeve të Bashkuara "Mbi të drejtën e Detit", Montego Bay 1982.

Pjesëmarrja me përfaqësues nga Institucionet:

Koordinatorët institucionalë (PKM, Dogana, Mjedisi, Peshkimi dhe Kapiteneria) dhe Grupet e shërbimit të sallës operationale, në QNOD.

Qëllimi i Trajnimit:

Ky trajnim ka si qëllim përcaktimin e vijës bregdetare shqiptare, karakteristikat e saj, ndarjen e Porteve, përcaktimin e ishujve, etj. Gjithashtu, ky trajnim ka si qëllim njohjen dhe zëbrthimin e detyrimeve të QNOD-së, në zbatim të Konventës së Kombeve të Bashkuara "Mbi të drejtën e Detit", Montego Bay 1982. Njohja e akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë bashkëpunimin midis institucioneve pjesë e QNOD-së dhe njohja e zbatimi i marrëveshjeve dypalëshe me vendet fqinje.

Subjekti shkurtuar i trajnimit:

Kodi Detar, Marrëveshjet dypalëshe midis institucioneve dhe me vendet fqinje.

Konventa e Kombeve të Bashkuara "Mbi të drejtën e Detit"

Metodologjia:

Trajnimi do të zhvillohet mbi një parapërgatitje të materialit të kursit (manual për pjesëmarrësit, prezantim në ppt), si dhe në shpjegime praktike. Mësimdhënia do të bëhet nga instruktorë të

kualifikuar të Kapitenerisë dhe Doganës, të cilët do të prezantojnë përmbajtjen teorike dhe praktike, si dhe do t'i përgjigjen pyetjeve që bëjnë pjesëmarrësit.

Metoda vlerësimit: Shpjegime, diskutime, pyetje-përgjigje

Planifikimi (Periudha): Shtator 2025

Kohëzgjatja: 2 ditë x 8 orë = 16 orë

Lektori: Specialistë nga Kapiteneria, Dogana, Juristi QNOD, koordinatorët institucionalë (PKM, RB, Dogana, Peshkimi, Kapiteneria, Mjedisi)

Vendi: Durrës

Nr i pjesëmarrësve: 20.

PËRMBAJTJA E PROGRAMIT MËSIMOR

Tema	Përmbajtja (Referenca)	Orë
Tema 1	• Njohja e legjislacionit detar, Kodit Detar	1
Tema 2	• Njohja dhe zbërthimi i Konventës së Kombeve të Bashkuara “Mbi të drejtën e detit”, firmosur në Montego Bay, Xhamaika 10 Dhjetor 1982	2
Tema 3	• Zbërthimi i detyrimeve të QNOD-së, në zbatim të Konventës	1
Tema 4	• E drejta mbi hapësirën detare, vija bregdetare, karakteristika, Portet shqiptare, zonat doganore, ishujt, etj	1
Tema 5	• Njohja e zbatimi i akteve ligjore e nënligjore midis institucioneve • Njohja dhe zbatimi i marrëveshjeve dypalëshe me vendet fqinje	2
	Diskutime, Pyetje, Përgjigje	1
SHUMA 2 ditë (në Durrës) x 8 orë = 16 orë		8

KOSTO FINANCARE

Emërtimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma (Lekë)
Blloqe	Copë	5	100	500
Dosje	Copë	20	60	1200
Letër A4	Risma	1	600	600
Shuma Totale				2300 lekë

Tema IV: Ndjekja e procedurave për vlerësimin e informacionit dhe marrjen e vendimeve sipas regjimeve të caktuara operationale

Pjesëmarrja me përfaqësues nga Institucionet:

Koordinatorët institucionalë dhe Grupet e shërbimit (personel në sallën operationale të QNOD-së) të PKM-së; Dogana-s; Kapitenerisë dhe Peshkimit.

Qëllimi i Trajnimit:

Ky modul ka si synim rritjen e njohurive të pjesëmarrësve në fushën e legjislacionit detar, mënyrën e organizimit të punës në QNOD, përcaktimin e regjimeve juridike, marrjen e vendimeve gjatë drejtimit operacional, etj.

Subjekti shkurtuar i trajnimit:

VKM Nr. 954, datë 30.09.2009 (i ndryshuar), Ligji i RB, PKM etj.

Metodologjia:

Trajnimi do të zhvillohet mbi një parapërgatitje të materialit të kursit (manual për pjesëmarrësit, prezantim në ppt), si dhe në shpjegime praktike. Mësimdhënia do të bëhet nga instruktorë të kualifikuar të RB-së, PKM-së, Doganës, Peshkimit, Kapitenerisë dhe QNOD-së, të cilët do të prezantojnë përmbajtjen teorike dhe praktike, si dhe do t'i përgjigjen pyetjeve që bëjnë pjesëmarrësit.

Metoda vlerësimit: Shpjegime, diskutime, pyetje-përgjigje

Planifikimi (Periudha): 2025

Kohëzgjatja: 2 ditë x 7 orë = 14 orë

Lektori: Specialistja e Mbështetjes Ligjore dhe Administratori i QNOD, koordinatoret institucional (PKM-së, RB-së, Peshkimit, Doganës, Mjedisit dhe Kapitenerisë)

Vendi: QNOD

Nr i pjesëmarrësve: 25.

PËRMBAJTJA E PROGRAMIT MËSIMOR

Tema	Përmbajtja (Referenca)	Orë
Tema 1	Vlerësimi i situatave dhe shkëmbimi i informacionit në sallën operationale në interes të marrjes së vendimit.	1
Tema 2	Peshkimi i paligjshëm dhe detyrat e Grupit të shërbimit në QNOD, në zgjidhjen e situatës	1
Tema 3	Detyrat e Oficerit Civil të PKM-së për operationet e Luftës kundër trafikimit të lëndëve narkotike	1
Tema 4	Detyrat funksionale të Sektorit të Antikontrabandës, bashkëveprimi me strukturat që operojnë në det për organizimin, drejtimin dhe zhvillimin e operationeve kundër trafikeve të mallrave kontrabandë.	1
Tema 5	Detyrat e Oficerit Civil të Turnit të Kapitenerisë në zbatimin e ligjit në det dhe mbështetja me informacion gjatë çdo operacioni	1
Tema 6	Detyrat e oficerit të RB-së gjatë drejtimit të Operationeve SAR dhe dhënie ndihme	1
	Diskutime, Pyetje, Përgjigje	1
SHUMA (2 ditë x 7 orë = 14 orë)		7

KOSTO FINANCARE

Emërtimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma (Lekë)
Bloqe	copë	5	100	500
Dosje	Copë	25	60	1500
Letër A4	Risma	1	600	600
Shuma Totale				2600 lekë

TEMA V: Stërvitje komplekse në Qëndrën e Simulimeve.

SAR/ Reagimi ndaj ndotjeve detare

Lloji i aktivitetit: Trajnimi bazë

Grupet e synuara: Kordinatorët, Grupet e shërbimit dhe personel nga QNOD.

Qëllimi i Kursit: Ky modul ka si synim përgatitjen e personelit që shërben në QNOD në zgjidhjen e detyrave konkrete sipas situatave të simuluar në teren, duke përfshir të gjitha hallkat e drejtimit të një operacioni(marjen e detyrës, sqarimin e situatës, vendimarjen, ecurin e operacionit për zgjidhjen e saj).

Objektivat e Modulit: 1. Të njihen pjesëmarrësit me Përdorimin e sistemit të simulimit.

1- Të aftësohen pjesëmarrësit zgjidhjen e detyrave reale si në teren.

2- Prefeksionimi i gjuhës së komunikimit dhe përdorimit të radiove.

3- Ritja e bashkëpunimit Institucional.

Metodologjia: Trajnimi do të zhvillohet mbi bazën e një skenari të parapregatitur në bashkëpunim me stafin e QS.

Metoda vlerësimit: Vlerësimi nga Grupi i Vlerësuesve.

Kohëzgjatja: 2 X 4 ditë (trajnim dhe stërvitje) = 8 ditë X 8 orë = 64 orë

Lektori: Grupi i Përbashkët i Punës QS + QNOD

Vendi: QS – Tiranë

Koha: Nëntor 2025

KOSTO FINANCARE

Emërtimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
Blloqe	Copë	25	100	2.500 Lekë
Dosje	Copë	25	32	800 Lekë
Stilolapsa	Copë	25	20	500 Lekë
Ujë 0,5 L	Copë	25	25	625 Lekë
Letër	Copë(risma)	1	600	600 Lekë
Lapustila	Copë	12	100	1200 Lekë
Harta	Copë	10	500	5000 Lekë
Fletë plastike harta	Copë	10	100	1000 Lekë
Shuma				12.225 Lekë

TRAJNIM (mbështetur nga të huajt)

1- (Pala britanike) UK Border Force

Tema: Trajnim mbi përdorimin e aplikacionit Lloyd's informa

Kohëzgjatja: 1 ditë x 6 orë = 6 orë

Lektori: Eksperti Britanik

Vendi: QNOD

KOSTO TOTALE E TRAJNIMEVE E STËRVITJEVE NDËRINSTITUCIONALE (QË REALIZOHEN NGA QNOD)

Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma (Lekë)
1	Blloqe	Copë	20	100	2000
2	Dosje	Copë	215	60	12900
3	Letër A4	Risma	4	600	2400
4	Dieta/Shërbime (QNOD)	Ditë	18	5500	99000
5	Dieta/Shërbime (QNOD)	Rrugë	22	1000	22000
Shuma Totale					138300 lekë

2- UNDP

Tema: Trajnim Reagimi ndaj ndotjeve detare (Oil spill Response)

Kohëzgjatja: 5 ditë x 6 orë = 30 orë

Lektori: Eksperti EMSA

Vendi: QNOD

KOSTO TOTALE E TRAJNIMEVE E STËRVITJEVE NDËRINSTITUCIONALE (QË REALIZOHEN NGA QNOD)

Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma (Lekë)
1	Blloqe	Copë	30	100	3000
2	Dosje	Copë	215	60	12900
3	Letër A4	Risma	10	600	6000
4	Dieta/Shërbime (QNOD)	Ditë	18	5500	99000
5	Dieta/Shërbime (QNOD)	Rrugë	22	1000	22000
Shuma Totale					142900 lekë

3- IALA

Tema: Masat e sigurise per bovat , hartat hidrografike

Kohëzgjatja: 3 ditë x 6 orë = 18 orë

Lektori: Eksperti IALA

Vendi: QNOD

KOSTO TOTALE E TRAJNIMEVE E STËRVITJEVE NDËRINSTITUCIONALE (QË REALIZOHEN NGA QNOD)

Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma (Lekë)
1	Blloqe	Copë	10	100	1000
2	Dosje	Copë	215	60	12900
3	Letër A4	Risma	10	600	6000
4	Dieta/Shërbime (QNOD)	Ditë	18	5500	99000
5	Dieta/Shërbime (QNOD)	Rrugë	22	1000	22000
Shuma Totale					142900 lekë

VIZITË PUNE

Tema: Shkëmbimi më i mirë i informacionit, me institucionet bashkëpunuese të vendeve homologe

Pjesëmarrja me përfaqësues nga Institucionet:

Koordinatorët institucionalë, Grupet e shërbimit (personel në sallën operacionale të QNOD-së) të PKM-së; RB-së; Dogana-s; Kapitenerisë dhe Peshkimit, si dhe personel nga QNOD.

Qëllimi i Vizitës:

Kjo vizitë ka si qëllim njohjen mbi mënyrën e organizimit dhe funksionimit të qendrave të vendeve homologe, si dhe rritjen e shkëmbimit të informacionit të QNOD-së me to.

Metodologjia:

Vizitë në institucionet/qendrat/agjencite me të cilat bashkëpunon QNOD, prezantim i shkurtër me qëllim njohjen mbi mënyrën e funksionimit dhe format e shkëmbimit të informacionit, tej.

Metoda vlerësimit: Shpjegime, diskutime, pyetje-përgjigje

Planifikimi (Periudha): e papërcaktuar

Kohëzgjatja: 15 ditë

Vendi: Papërcaktuar

Nr i pjesmarrësve: 20.

II. TRAJNIMET QË OFROHEN NGA MINISTRIA E MBROJTJES

- 1- Trajnime në fushën e kontabilitetit dhe të aplikimit të programit alfa web;
- 2- Trajnim mbi arkivin dhe rregullat e arkivimit të shkresave;
- 3- Trajnim mbi informacionin e klasifikuar (sekret, t/sekret dhe konfidencial);
- 4- Trajnimet që ofrohen nga ASPA.

III. TRAJNIMET QË OFROHEN NGA PARTNERET/MISIONIT (Frontex, EMSA, UNODC, UK Border Force, Atasheu Ushtarak Britanik, etj)

- 1- Zona Ekonomike Ekskluzive (EEZ);
- 2- Trajnime në fushën e analizës së riskut (CIRAM);
- 3- Trajnim në fushën e sigurisë kompjuterike;
- 4- Trajnim në fushën juridike (legjislacioni detar kombëtar dhe ndërkombëtar);
- 5- Vizita studimore në qendrat homologe, në: Angli etj.